



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M

Nr. 31, datë 30.01.2023

PËR

**CAKTIMIN E MASËS DISIPLINORE NDAJ MAGJISTRATIT EDMOND KARIQI,  
ME DETYRË PROKUROR NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË RRETHIT  
GJYQËSOR LUSHNJË**

Bazuar në nenet 148/d, pikat 1 dhe 2, germa “b” dhe 3, 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 101, pika 1, germa “a”, 104, pika 3, 105, pika 1, germa “dh”, si dhe 111, pika 1, germa “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 189, pika 1, germa “a”, 190, pikat 1 dhe 2, si dhe 192, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 104, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregulloren “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr. 260, datë 17.11.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me propozim të Komisionit Disiplinor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës Nr.2200/1 prot., datë 27.12.2022, të paraqitur nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedim disiplinor ndaj prokurorit Edmond Kariqi, për shkelje që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, parashikuar nga neni 148/d, pika 2, germa “b”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
2. Dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për magjistratin Edmond Kariqi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
3. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit Edmond Kariqi brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes.

4. Të njoftohet për zbatimin e këtij vendimi Prokurori i Përgjithshëm si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të përcaktuar nga neni 50, pika 4, të Ligjit nr. 8577, dt. 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR**  
Alfred Balla

**ZV/KRYETAR**  
Tartar Bazaj

**ANËTAR**  
Sokol Stojani

**ANËTAR**  
Bujar Sheshi

**ANËTAR**  
Nurhan Seiti

**ANËTAR**  
Eloida Goxhi

**ANËTAR**  
Esmeralda Keshi

**ANËTAR**  
Zeqir Hoda

**ANËTAR**  
Mirela Bogdani

**ANËTAR**  
Arta Mandro

**ANËTAR**  
Ledina Riza